



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure*

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 paragrafin 1.2, nenin 45 paragrafin 3, nenin 62 paragrafin 2, nenin 63, nenin 64 paragrafin 5, nenin 66 paragrafin 1, nenit 68 paragrafit 5, nenit 69, në referencë me nenet 52, 55, 58 dhe Nënkreun V të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, nenin 38 paragrafin 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 dhe nenin 8 paragrafin 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, nxjerr:

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 03/2013
PËR VENDOSJEN PËRCAKTIMIN DHE ARKËTIMIN E PAGESAVE
TË QASJES NË INFRASTRUKTURË HEKURUDHORE**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim vendosjen, përcaktimin dhe arkëtimin e pagesave të qasjes në Infrastrukturë Hekurudhore, detajizimin e kornizës së pagesës duke respektuar pavarësinë e menaxhmentit, për sa i përket menaxhimit të kostos, mënyrës së llogaritjes dhe mbajtjes së llogarive të pagesave për qasje në infrastrukturë dhe mbledhjes së të hyrave që rezultojnë nga pagesat e qasjes në infrastrukturë, kurdoherë që menaxheri i infrastrukturës hekurudhore i shfrytëzimit të përbashkët në mënyrë direkte ose indirekte zotërohet apo kontrollohet nga shteti, ose ka një koncesion për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore sipas Nenit 127 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

**Neni 2
Organi për Pagesa**

1. INFRAKOS është organi i cili bënë përcaktimin e pagesave për infrastrukturën ekzistuese hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët.

2. Cilido menaxher i infrastrukturës hekurudhore i shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë i cili ka licencë dhe autorizim të sigurisë, është organ i cili bënë përcaktimin e pagesave.
3. Cilido organ i cili bënë përcaktimin e pagesave ashtu siç është definuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, e propozon strukturën e sistemit të pagesave të shfrytëzimit të qasjes dhe nivelin e përgjithshëm të pagesave të shfrytëzimit për autoritetet e përmendura në Nenin 3.

Neni 3

Miratimi i pagesave të infrastrukturës

Ministria e Infrastrukturës, në pajtim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik e bëjnë miratimin e strukturës dhe nivelit të përgjithshëm të pagesave të menaxherit të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët të zotëruar nga shteti.

Neni 4

Marrëveshjet specifike

Përveç për rastet ku janë bërë marrëveshjet specifike sipas Nenit 66 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët do të sigurojnë që skema e cila përdoret për pagesa është e bazuar në parimet e njëjta për tërë rrjetin e tyre.

Neni 5

Kostot dhe llogaritë e Infrastrukturës

1. Duke pasur parasysh sigurinë, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve të infrastrukturës, duhet të bëhet stimulimi i menaxherëve të infrastrukturës në mënyrë që ata të bëjnë zvogëlimin e kostove të ofrimit të infrastrukturës dhe nivelit të pagesave të qasjes.
2. Stimulimi duhet të definohen me marrëveshjen kontraktuale në mes të qeverisë dhe menaxherit të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët. Qëllimi i tyre duhet të jetë që të reduktohen kostot në operim dhe mirëmbajtje të rrjetit hekurudhor, të zvogëlohet niveli i pagesave për pakon minimale të qasjes, qasjen në binar deri te pajisjet shërbyese, si dhe për furnizimin me shërbimet e ofruara nga menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët.
3. Në lidhje me shërbimet shtesë dhe shërbimet ndihmëse të përcaktuara me Nenin 52 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, stimulimet e tilla jepen vetëm nëse menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët:
 - 3.1. e ka fuqinë e monopolit të tregut, gjë që do të mund të shkaktonte disavantazhe të konkurrencës për operatorët hekurudhor në tregun e transportit;
 - 3.2. shfaq shenja të abuzimit të fuqisë së tregut të cilat nuk mund të shfuqizohet apo reduktohet nga fuqitë e tregut;
 - 3.3. aplikon një politikë të pagesave e cila do të provokon një shtrembërim në tregun përkatës i cili ofron shërbimet relevante.

4. Marrëveshja kontraktuale duhet t'i përmbushë parimet dhe parametrat bazë të caktuara në Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ.

5. Nëse është e nevojshme marrëveshja kontraktuale e kërkuar me Nenin 63.3. të Ligjit mbi Hekurudhat mund të modifikohet për ta radhitur atë me dispozitat e legjislacionit më të fundit evropian në pajtueshmëri me Nenin 144 paragrafin 6 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

6. Termat e marrëveshjes kontraktuale të referuara në paragrafin 4, si dhe struktura e pagesave e dakorduar për të siguruar financim për menaxherin e infrastrukturës, duhet të dakordohen paraprakisht, ashtu që të mbulohet e tërë perioda kontraktuese.

7. Menaxherët e infrastrukturës duhet të rifreskojnë kohë pas kohe metodën e shpërndarjes së kostove në kategoritë e ndryshme të shërbimeve të ofruara për operatorët hekurudhor, ashtu siç është përcaktuar në bazë të përvojës më të mirë ndërkombëtare.

Neni 6 **Parimet e pagesës**

1. Pagesat për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore dhe të pajisjeve shërbyese duhet t'i paguhen menaxherit të infrastrukturës, respektivisht operatorit të pajisjeve shërbyese dhe të përdoren për të financuar biznesin e tyre.

2. Menaxheri i infrastrukturës dhe operatori i pajisjeve shërbyese duhet të jenë në gjendje t'ju demonstrojnë operatorëve hekurudhor se pagesat e infrastrukturës dhe shërbimit të cilat i janë faturuar operatorit hekurudhor, janë në pajtueshmëri me metodologjinë, rregullat, dhe aty ku është e aplikueshme edhe me masat e përcaktuara në ekspozitën e rrjetit.

3. Pagesat e infrastrukturës mund të modifikohen duke marrë parasysh kështu edhe koston e efekteve mjedisore të shkaktuara nga operimi i trenit. Kjo duhet të bëhet duke u bazuar në përvojën e fituar nga menaxherët e infrastrukturës, operatorët hekurudhor, organet rregullative dhe autoritetet kompetente, si dhe duke njohur skemat ekzistuese të diferencimit të zhurmës dhe të dakorduar në një proces konsultimi të mbikëqyrur nga Organi Rregullativ i Tregut. Pagesat e dakorduara të infrastrukturës nuk duhet të rezultojnë në shtrembërim të papërshtatshëm të konkurrencës ndërmjet operatorëve hekurudhor dhe të dëmtojnë konkurrencën e përgjithshme të sektorit hekurudhor. Çfarëdo modifikimi i tillë i pagesave të infrastrukturës i cili merr parasysh koston e efektit të zhurmës duhet të përkrahë modifikimin e vagonëve me një teknologji ekonomikisht të zbatueshme e cila disponon me një zhurmë më të vogël të frenimit.

4. Pagesat e imponuara për qasje në binar brenda pajisjeve shërbyese të bazuara në Nenin 52, paragrafin 4.2 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, nuk duhet të tejkalojnë koston e ofrimit të tyre, plus një përfitimi të arsyeshëm. Qasja në binar për shërbimet, nuk duhet ta tejkalon koston direkte të shkaktuar për ofrimin e shërbimeve të tilla.

5. Aty ku ofrohen shërbimet shtesë dhe ato ndihmëse nga vetëm një furnizues sipas Nenit 52, paragrafit 4.3 dhe 4.4, pagesat e imponuara për një shërbim të tillë nuk duhet të tejkalojnë koston e ofrimit të tij, plus një përfitimi të arsyeshëm.

Neni 7
Përjashtimet nga parimet e pagesës

1. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të garantojë konkurrencë të segmenteve të tregut hekurudhor ashtu siç është definuar në listën e ngritjes së çmimeve.
2. Niveli i ngritjeve të çmimit duhet të respektojë rritjen e produktivitetit i cili arrihet nga operatorët hekurudhor si pasojë e ngritjes së çmimeve. Megjithatë, niveli i ngritjes së çmimeve nuk do të përjashtojë shfrytëzimin e infrastrukturës me segmentet e tregut ashtu siç është definuar në listë, e të cilët së paku mund të paguajnë koston direkte që është shkaktuar si rezultat i operimit të shërbimeve hekurudhore, plus një shumë të kthimit të cilën mund ta bart tregu.
3. Menaxherët e infrastrukturës duhet të vlerësojnë relevancën e ngritjeve të çmimit për segmentet specifike të tregut, duke konsideruar kështu së paku çiftet e vendosura në listë në paragrafin 7 të këtij neni, si dhe duke mbajtur ato të cilat janë relevante.
4. Lista e segmenteve të tregut të definuara nga menaxherët e infrastrukturës duhet të përmbajné së paku tri segmente vijuese: shërbimet e mallrave, shërbimet e udhëtarëve brenda kornizës së një kontrate të shërbimit publik dhe shërbimet komerciale të udhëtarëve.
5. Menaxherët e infrastrukturës më tej mund të ndajnë segmentet e tregut sipas komoditetit apo udhëtarëve të transportuar.
6. Segmentet e tregut në të cilët operatorët hekurudhor nuk operojnë aktualisht por mund të ofrojnë shërbime gjatë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të pagesës, po ashtu duhet të definohen. Menaxheri i infrastrukturës nuk do të përfshijë një ngritje çmimi në sistemin e pagesës për ato segmente të tregut. Lista e segmenteve të tregut do të publikohet në ekspozitë dhe do të rishikohet së paku çdo pesë vite.
7. Çiftet e segmenteve të tregut të cilat duhet të merren në konsiderim nga menaxherët e infrastrukturës gjatë definimit të listës të segmenteve të tregut me pikëpamje të futjes së ngritjes së çmimeve në sistemin e pagesës, së paku përfshijnë këto në vijim:
 - 7.1. Shërbimet e udhëtarëve kundrejt shërbimeve të mallrave;
 - 7.2. Trenat që bartin mallrat e rrezikshme kundrejt trenave tjerë të mallrave;
 - 7.3. Shërbimet vendore kundrejt atyre ndërkombëtare;
 - 7.4. Transportin e kombinuar kundrejt trenave direkt;
 - 7.5. Shërbimet urbane ose rajonale të udhëtarëve kundrejt atyre ndër-urbane;
 - 7.6. Bllok trenat kundrejt trenave të ngarkuar me vagon të thjeshtë;
 - 7.7. Shërbimet e trenave të rregullt kundrejt atyre të rastit.

8. Para futjes së ngritjes së çmimeve dhe nivelit të tyre të pagesave, menaxheri i infrastrukturës duhet të:

8.1. Vërtetoj garantimin e konkurrencës së segmentit të tregut të Rregullatori i Tregut Hekurudhor;

8.2. Vërtetoj përfitimet potenciale të produktivitetit për operatorët hekurudhor;

8.3. Paraqes segmentet e tregut për të cilët menaxheri i infrastrukturës mendon se mund të paguajnë së paku koston direkte të shkaktuar si rezultat i operimit të shërbimit hekurudhor, plus një ratë kthimi të cilën mund ta bart tregu;

8.4. Paraqes listën e segmenteve të tregut;

8.5. Paraqes segmentet e tregut të cekura në paragrafin 4;

8.6. Paraqes çiftet e segmenteve të tregut të cilat do të konsiderohen për ngritje të çmimit të Rregullatori i Tregut Hekurudhor i cili do të vendos për përshtatjen e tregut dhe do të kontrollojë mënyrën jo-diskriminuese të masave.

9. Për projektet specifike të investimit në të ardhmen, apo projektet specifike të investimit që janë kompletuar pas datës 31.12.2012, menaxheri i infrastrukturës mund të vendos apo të vazhdojë të vendos pagesa më të larta në bazë të kostove afatgjata të projekteve të tilla nëse ato rrisin efikasitetin apo efektivitetin e koston ose të dyja së bashku, dhe se nuk mund apo nuk do të mund të ndërmerreshin ndryshe. Një rregullim i tillë i pagesave mundet po ashtu të përfshijë marrëveshjen mbi ndarjen e rrezikut të ndërlidhur me investimet e reja.

10. Për të parandaluar diskriminimin, menaxheri i infrastrukturës do të sigurojë se çdo pagesë e caktuar e menaxherit të infrastrukturës për shfrytëzim ekuivalent të infrastrukturës së tij është e krahasueshme dhe se shërbimet e krahasueshme në segmentin e njëjtë të tregut i nënshtrohen pagesave të njëjta. Menaxheri i infrastrukturës duhet të paraqes në Ekspozeun e Rrjetit se sistemi i pagesave i plotëson këto kërkesa për derisa kjo mund të bëhet pa i zbuluar informatat konfidenciale të biznesit.

11. Nëse menaxheri i infrastrukturës synon të modifikojë elementet thelbësore të sistemit pages siç është formula e llogaritjes dhe koeficientet e saj, apo pagesat në Kapitullin 6 të Ekspozeut të Rrjetit, ai duhet t'i bëjë ato publike jo më vonë se 4 (muaj) para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesave për trasetë e trenit.

Neni 8 Zbritjet

1. Çdo zbritje e pagesave të vëna për një operator hekurudhor nga menaxheri i infrastrukturës për cilindo shërbim, duhet të jetë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në këtë Nen dhe me parimet e koston direkte të përcaktuar në Kapitullin V dhe nenin 67 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2013 Për Llogaritjen e

Shpenzimeve të Drejtpërdrejta të Shkaktuara nga Shërbimet Operative me Tren dhe Mirëmbajtja e Infrastrukturës

2. Përgjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, zbritjet do të kufizohen në ruajtjen aktuale të kostos administrative për menaxherin e infrastrukturës. Në përcaktimin e nivelit të zbritjes nuk mund të merren parasysh llogaritë e ruajtjes së kostove të cilat veçse janë të futura në pagesat e vëna.
3. Menaxherët e infrastrukturës mund të paraqesin në dispozicion skemat për të gjithë shfrytëzuesit e infrastrukturës për rrjedhjet specifike të trafikut, duke ofruar kështu zbritje të përkohshme në mënyrë që të inkurajohen zhvillimet e shërbimeve të reja hekurudhore, ose zbritje të cilat inkurajojnë shfrytëzimin e linjave që janë në mënyrë të konsiderueshme të pashfrytëzuara.
4. Zbritjet mund të ndërlidhen vetëm me pagesat e vëna për një sektor specifik të infrastrukturës.
5. Skemat e ngjashme të zbritjes duhet të aplikohen për shërbimet e ngjashme. Skemat e zbritjes duhet të aplikohen në mënyrë jo-diskriminuese për çdo operator hekurudhor.

Neni 9

Skema e performances dhe marrëveshja

1. Parimet bazë të skemës së performances janë paraqitur në listën e paragrafit 2 të këtij neni, skema duhet të publikohen në Ekspozeun e Rrjetit. Ato duhet të jenë pjesë e marrëveshjes së performances që do të arrihet me aplikuesin i cili duhet të jetë një operator hekurudhor.
2. Skema e performancës duhet të bazohet në parimet vijuese:
 - 2.1. Në mënyrë që të arrihet një nivel i pajtueshëm i performances dhe që të mos rrezikohet zbatueshmëria ekonomike e shërbimeve, menaxheri i infrastrukturës duhet të dakordohet me aplikuesin lidhur me parametrat kryesor të skemës së performances, në veçanti për vlerën e vonesave dhe pragjet e pagesave të caktuara nën skemën e performances relative për lëvizjet individuale të trenit dhe po ashtu edhe për të gjitha lëvizjet e trenave të operatorit hekurudhor në një periudhë të caktuar kohore;
 - 2.2. Menaxheri i infrastrukturës duhet të ua komunikojë operatorëve hekurudhor orarin e punës në bazë të cilit do të llogariten vonesat, së paku pesë ditë para lëvizjes së trenit. Në rast të forcës madhore apo ndryshimeve të mëvonshme të orarit të punës, menaxheri i infrastrukturës mund të aplikojë një periudhë më të shkurtër njoftimi;
 - 2.3. Të gjitha vonesat duhet t'i atribuohen njëres prej klasave apo nën-klasave të vonesave në vijim:

2.3.1. Menaxhimi i operimit/planifikimit i cili i atribuohet menaxherit të infrastrukturës:

- 2.3.1.1. Përpilimi i orarit
- 2.3.1.2. Formimi i trenit
- 2.3.1.3. Gabimet në procedurën e operimeve
- 2.3.1.4. Aplikim i gabuar i rregullave prioritare
- 2.3.1.5. Stafi
- 2.3.1.6. Shkaqet tjera

2.3.2. Stabilimentet e infrastrukturës të cilat i atribuohen menaxherit të infrastrukturës:

- 2.3.2.1. Stabilimentet e sinjalizimit
- 2.3.2.2. Stabilimentet e sinjalizimit në vendkalimet në nivel
- 2.3.2.3. Stabilimentet e telekomunikacionit
- 2.3.2.4. Pajisjet e furnizimit me rrymë
- 2.3.2.5. Binarët
- 2.3.2.6. Shtresat hekurudhore
- 2.3.2.7. Stafi
- 2.3.2.8. Shkaqet tjera

2.3.3. Shkaqet e ndërtimtarisë të cilat i atribuohen menaxherit të infrastrukturës:

- 2.3.3.1. Puna e planifikuar e ndërtimit
- 2.3.3.2. Parregullsitë në kryerjen e punëve të ndërtimit
- 2.3.3.3. Kufizimet e shpejtësisë për shkak të binarit të dëmtuar
- 2.3.3.4. Shkaqet tjera

2.3.4. Shkaqet të cilat i atribuohen menaxherëve tjerë të infrastrukturës:

- 2.3.4.1. Të shkaktuara nga menaxheri i mëparshëm i infrastrukturës
- 2.3.4.2. Të shkaktuara nga menaxheri i ardhshëm i infrastrukturës

2.3.5. Shkaqet komerciale të cilat i atribuohen operatorit hekurudhor:

- 2.3.5.1. Tejkalimi i kohës së ndaljes
- 2.3.5.2. Kërkesa e operatorit hekurudhor
- 2.3.5.3. Operacionet e ngarkimit
- 2.3.5.4. Parregullsitë e ngarkimit
- 2.3.5.5. Përgatitja komerciale e trenit
- 2.3.5.6. Stafi
- 2.3.5.7. Shkaqet tjera

2.3.6. Mjetet lëvizëse të cilat i atribuohen operatorit hekurudhor:

- 2.3.6.1. Planifikimi i orarit/ ri-planifikimi
- 2.3.6.2. Formimi i trenit nga operatori hekurudhor
- 2.3.6.3. Problemet që ndikojnë në vagonë (transporti i udhëtarëve)
- 2.3.6.4. Problemet që ndikojnë në vagonë (transporti i mallrave)
- 2.3.6.5. Problemet që ndikojnë në drezina, lokomotiva dhe trena motorik
- 2.3.6.6. Stafi

2.3.6.7. Shkaqet tjera

2.3.7. Shkaqet të cilat i atribuohen operatorëve tjerë hekurudhor:

- 2.3.7.1. Të shkaktuara nga operatori i ardhshëm hekurudhor
- 2.3.7.2. Të shkaktuara nga operatori i mëparshëm hekurudhor

2.3.8. Shkaqet e jashtme të cilat nuk i atribuohen as menaxherit të infrastrukturës dhe as operatorit hekurudhor:

- 2.3.8.1. Sulmi
- 2.3.8.2. Formalitetet administrative
- 2.3.8.3. Ndikimi nga jashtë
- 2.3.8.4. Efektet e motit dhe shkaqet natyrore
- 2.3.8.5. Vonesa për shkaqe të jashtme në rrjetin tjetër
- 2.3.8.6. Shkaqet tjera

2.3.9. Shkaqet dytësore të cilat nuk i atribuohen as menaxherit të infrastrukturës dhe as operatorit hekurudhor:

- 2.3.9.1. Incidentet e rrezikshme, aksidentet dhe rreziqet
- 2.3.9.2. Zënia e binarit e shkaktuar nga vonesa e trenit të njëjtë
- 2.3.9.3. Zënia e binarit e shkaktuar nga vonesa e një treni tjetër
- 2.3.9.4. Kthimi i trenit
- 2.3.9.5. Lidhja e trenit
- 2.3.9.6. Nevoja për hetimi të mëtutjeshëm.

3. Vonesat duhet t'i atribuohen një organizate të vetme kurdoherë që kjo të jetë e mundur, qoftë ky menaxheri i infrastrukturës, operatori hekurudhor apo ofruesit tjerë të shërbimeve të përfshirë në skemë, duke marrë në konsiderim përgjegjësinë për shkaktarin e parregullsisë si dhe aftësinë për të ri-vendosur kushtet normale të trafikut;

4. Llogaritja e pagesave duhet të merr parasysh mesataren e vonesës së shërbimeve të trenit sipas kërkesave të përpikërive të ngjashme të orarit;

5. Menaxheri i infrastrukturës do t'ia komunikojë operatorëve hekurudhor sa më parë që të jetë e mundur llogaritjen e pagesave të përcaktuara nën skemën e performancës. Kjo llogaritje do të përmbledh të gjitha vonesat e lëvizjes së trenave brenda një periudhe jo më shumë se një muaj;

6. Në rast të mosmarrëveshjeve që ndërlidhen me skemën e performancës, atëherë duhet të krijohet një sistem i zgjidhjes së mosmarrëveshjes në mënyrë që çështjet e tilla të rregullohen me përpikëri. Ky sistem i zgjidhjes së mosmarrëveshjes duhet të jetë i paanshëm kundrejt palëve të përfshira. Në rast të aplikimit të këtij sistemi, vendimi duhet të merret brenda një limiti kohor prej 10 ditëve të punës. Partnerët kontraktues janë të lirë për të zgjedhur sistemin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes,

7. Menaxheri i infrastrukturës duhet që një herë në vit ta publikojë nivelin mesatar vjetor të performancës së arritur nga operatorët hekurudhor duke u bazuar në parametrat kryesor të dakorduar në skemën e performances.

8. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të informojë organin rregullativ të tregut hekurudhor lidhur me realizimin e secilës marrëveshje të performancës.

Neni 10 **Pagesat e rezervimit**

1. Bazuar në Nenin 69 të Ligjit mbi Hekurudhat, menaxherët e infrastrukturës mund të vejnë një pagesë të përshtatshme për kapacitet e ndara por të cilat nuk shfrytëzohen. Kjo pagesë për mos shfrytëzim duhet që të ofrojë stimulim për shfrytëzim efikas të kapacitetit.

2. Vënia e një pagese të tillë për aplikuesit të cilëve u është ndarë një trase e trenit, duhet të jetë e detyrueshme në rast të dështimit të tyre të rregullt për të shfrytëzuar trasetë e ndara ose një pjesë të tyre.

3. Për imponim të kësaj pagese, menaxherët e infrastrukturës duhet të publikojnë në ekspozetë e tyre të rrjeteve kriteret me të cilat përcaktohet një dështim i tillë i shfrytëzimit të rregullt të traseve.

4. Organi rregullativ i tregut hekurudhor duhet të mbikëqyrë kriteret e tilla sipas Neneve 55 dhe 56 të Ligjit mbi Hekurudhat. Pagesat e këtyre detyrimeve duhet të bëhen nga operatori hekurudhor me të cilin është nënshkruar marrëveshja korresponduese për qasje në binar.

Neni 11 **Bashkëpunimi në lidhje me sistemet e pagesës në më shumë se një rrjet**

1. Menaxherët e infrastrukturës përmes proceseve të përshtatshme të ndarjes së traseve, duhet që në veçanti të synojnë të garantojnë konkurrencë të shërbimeve hekurudhore ndërkombëtare. Lidhur me ankesën e një operatori hekurudhor i cili ofron shërbime hekurudhore ndërkombëtare, organi rregullativ i tregut hekurudhor në bashkëpunim të ngushtë me rregullatorin hekurudhor korrespondues të tregut hekurudhor, në bazë të Nenit 26.10 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës duhet të vendos mbi konkurrencën e proceseve të alokimit të traseve.

2. Ata duhet të sigurojnë shfrytëzimin efikas të vendkalimeve kufitare me rrjetet fqinje në mënyrë që të minimizohet koha e përcjelljes së trenave në kufi.

3. Për këtë qëllim ata duhet të vendosin procedura të përshtatshme jo-diskriminuese dhe transparente, të nënshtruara ndaj rregullave të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të kalimeve kufitare. Menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët janë të lirë që të përfshijnë rregullat dhe rregulloret mbi kalimet kufitare në ekspozetë e tyre përkatëse të rrjetit ose të përpilojnë një ekspozetë të përbashkët të rrjetit i cili i jep në detaje procedurat e kalimit kufitar. Në rastin e fundit, ekspozetë e tillë të rrjetit duhet të përfshijë një strukturë të përbashkët të dakorduar, strukturë kjo e cila mund të jetë e ndryshme prej strukturës së shfrytëzuar nga menaxherët e

infrastrukturës në Kosovë. Sidoqoftë, kjo strukturë duhet të përmbajë pikat parimore që janë paraqitur në paragrafin 4.

4. Pikat parimore janë:

4.1. Një seksion i cili përcakton natyrën e infrastrukturës në zonën e kalimit kufitar që është në dispozicion për operatorët hekurudhor dhe kushtet e qasjes në te. Informacioni në këtë seksion duhet të jetë në përputhje, ose të iu referohet regjistrave të infrastrukturës hekurudhore në baza vjetore;

4.2. Një seksion mbi parimet e pagesës dhe tarifat. Kjo duhet të përmbajë detajet e përshtatshme të skemave të pagesës të menaxherëve të infrastrukturës, informacionet e mjaftueshëm mbi pagesat, si dhe informacionin tjetër relevant mbi qasjen e aplikuar në shërbimet e ofruara në zonën e kalimit kufitar;

4.3. Një seksion mbi parimet dhe kriteret për alokimin e kapaciteteve në zonën e kalimit kufitar, në veçanti kërkesat të cilat kanë të bëjnë me procedurën *ad hoc* për trafikun ndërkombëtar. Kërkesat për alokimin e kapacitetit duhet të kenë një formë të caktuar (shabllon);

4.4. Një seksion mbi informacionin lidhur me pranimin e licencave dhe certifikatave të sigurisë në zonën e kalimit kufitar e cila duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e vendosura në marrëveshjet e kalimit kufitar;

4.5. Një seksion mbi informacionin rreth procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesave lidhur me çështjet e qasjes në hekurudhë sipas përcaktimeve të vendosura në marrëveshjet e kalimit kufitar;

4.6. Një seksion mbi informacionin për qasjen dhe caktimin e pagesave për pajisjet shërbyese në zonën e kalimit kufitar. Pajisjet shërbyese brenda zonës së kalimit kufitar të cilat nuk kontrollohen nga menaxherët e infrastrukturës duhet të japin informacionin mbi pagesat për qasje në këto pajisje dhe për ofrimin e shërbimeve, si dhe informacionin mbi kushtet teknike të qasjes në mënyrë që të përfshihet në ekspozitë e rrjetit; ose duhet të tregohet ueb faqja ku informacioni i tillë është në dispozicion pa pagesë në formatin elektronik.

Neni 12
Hierarkia Ligjore

Kur dispozitat e akteve nënligjore janë kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore, automatikisht zbatohen dispozitat akteve ligjore në fuqi.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prishtinë,

20.06.2013

Fehmi Mujota
Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës



SHTOJCA 1

Parimet dhe parametrat bazë të marrëveshjeve kontraktuale në mes të autoriteteve kompetente dhe menaxherëve të infrastrukturës (bazuar në Nenin 63.3 të Ligjit mbi Hekurudhat dhe Nenit 5.4 të këtij Udhëzimi Administrativ)

1. Marrëveshja kontraktuale duhet të specifikojë dispozitat e Nenit 63.3 të Ligjit mbi Hekurudhat dhe Nenit 5.5 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe të përfshijë së paku elementet vijuese:

1.1. Sferën e marrëveshjes sa i përket infrastrukturës dhe pajisjeve shërbyese, të strukturuar sipas Nenit 52 të Ligjit mbi Hekurudhat. Kjo duhet t'i mbulojë të gjitha aspektet e menaxhimit të infrastrukturës, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe përtëritjen e infrastrukturës e cila gjendet në operim. Aty ku është e përshtatshme, po ashtu mund të mbulohet edhe ndërtimi i infrastrukturës së re.

1.2. Strukturën e pagesave ose fondeve të ndara për shërbimet e infrastrukturës për mirëmbajtje dhe përtëritje, si dhe trajtimin e mirëmbajtjes ekzistuese dhe përtëritjen e pagesave të mbetura. Aty ku është e përshtatshme, po ashtu mund të mbulohet struktura e pagesave apo fondeve të ndara për infrastrukturën e re.

1.3. Objektivat e performancës të orientuara kah shfrytëzuesit në formë të treguesve dhe kriterëve të kualitetit të cilat i mbulojnë elementet vijuese:

- 1.3.1. Performancën e trenit, siç është serioziteti dhe shpejtësia në linjë, si dhe kënaqshmëria e klientit;
- 1.3.2. Kapacitetin e rrjetit;
- 1.3.3. Menaxhimin e aseteve;
- 1.3.4. Vëllimet e aktiviteteve;
- 1.3.5. Nivelet e sigurisë, dhe
- 1.3.6. Mbrojtjen e mjedisit.

2. Sasinë e punëve të pakryera të mirëmbajtjes dhe asetet të cilat do të dalin jashtë përdorimit, që për pasojë kanë rrjedhje të ndryshme financiare.

3. Stimulimet sipas Nenit 5.1 duke përjashtuar ato stimulime të zbatuara përmes masave rregullative sipas Nenit 5.3.

4. Obligimet minimale të raportimit për menaxherin e infrastrukturës në termet e përmbytjes dhe frekuencës së raportimit, duke përfshirë informacionin që publikohet në baza vjetore.

5. Kohëzgjatjen e dakorduar të marrëveshjes e cila duhet të sinkronizohet dhe të jetë në përputhje me kohëzgjatjen e planit të biznesit të menaxherit të infrastrukturës, aty ku është e përshtatshme me kohëzgjatjen e koncesionit apo licencës, si dhe kornizën e pagesave dhe rregullat e vendosura nga shteti.

6. Rregullat mbi veprimet në rastet e çrregullimeve të mëdha të operimeve dhe situatave emergjente, duke përfshirë këtu planet e rastësishme dhe ndërprerjen e parakohshme të marrëveshjes kontraktuale, si dhe informimin me kohë të shfrytëzuesve.

7. Masat riparuese të cilat duhet të ndërmerren nëse cilado nga palët ka bërë shkelje të obligimeve kontraktuale, apo në rrethana të jashtëzakonshme ka prekur në disponueshmërinë e fondeve publike; kjo përmban kushtet dhe procedurat për ri-negocimin dhe ndërprerjen e parakohshme.